



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

*Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister*

---

Kam kënaqësinë të paraqes raportin për të arriturat kryesore të punës gjatë periudhës (shtator 2017- qershor 2018), të Ministrisë së Drejtësisë (MD).

Ministria e Drejtësisë gjatë kësaj periudhe nëntë (9) mujore është angazhuar në zbatimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës për fushën e drejtësisë, si dhe përmbushjen dhe realizimin e objektivave, programeve dhe projekteve sektoriale, si pjesë e dokumenteve strategjike të saj.

Ministria e Drejtësisë, pas hartimit (tetor 2017) të Planit Zhvillimor Strategjik 2018-2021, ka ndërmarrë veprime konkrete për realizimin e aktiviteteve të parapara për zbatimin e tij, si dhe aktiviteteve që janë në funksion të objektivave dhe prioriteteve programore të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Llogaridhënia dhe transparenca janë parimet kyçe të një demokracie të shëndoshë dhe funksionale. MD është proaktive në dhënien e informatave për punën që bënë, por edhe përgjegjëse karshi qytetarëve për mënyrën sesi shpenzon paratë publike, përmes publikimit të *Shpenzimeve Javore* në ueb faqen zyrtare.

Raporti Nëntë Mujor i Punës, dhe raportet tjera që do të hartohen, do të jenë gjithnjë publike.

Si më sipër, gjeni të bashkëlidhur kësaj shkrese, Raportin e Punës së Ministrisë së Drejtësisë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

**REFORMA LEGJISLATIVE NË DREJTËSI** – Gjatë periudhës raportuese, Ministria e Drejtësisë ka punuar në ndryshime substanciale të legjislacionit në sektorin e drejtësisë, duke rishikuar/hartuar Projekt-Kode, Projektligje, Koncept-Dokumente dhe akte tjera nënligjore, në fushat përkatëse si: lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, reformën e Gjyqësorit, Rishikimin e legjislacionit Penal dhe reformat në fushën civile, si në vijim:

- Sa i përket luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar si dhe përmbushjes së obligimeve që dalin nga Agjenda Evropiane janë miratuar Projektligjet si në vijim: Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit, Projektligji për Kompetencat e zgjeruara për Konfiskimin e pasurisë dhe Projektligji për Mbrojtjen e Informatorëve.
- Sa i përket Reformave në Gjyqësorë janë miratuar Projektligjet si në vijim: Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Projektligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Projektligji për Gjykatat, Projektligji për Përgjegjësitë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokuror, Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Projektligji për Ndërmjetësimin.
- Ndërsa, sa i përket Rishikimit të legjislacionit Penal është miratuar Kodi i ri Penal dhe Kodi i Drejtësisë për të mitur dhe janë në përfundim të procesit të hartimit Projekt-Kodi i Procedurës Penale dhe Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale.
- Lidhur me reformat në fushën Civile është duke u hartuar draft Kodi Civil, Projektligji për Noterinë, Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Procedurën Jo-Kontestimore dhe Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për Trashëgimi.

**RISHIKIMI FUNKSIONAL I SEKTORIT TË SUNDIMIT TË LIGJIT**- Me vendim të Qeverisë është miratuar RFSSS në qëllim të ngritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë. Procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit do ofrojë pasqyrë konkrete të gjendjes brenda këtij sektori dhe do rezultojë me Strategji për plotësimin apo reformimin eventuale të zbrazëtirave, respektivisht tërësisht të sistemit. Deri më tani, është hartuar Koncept-Dokumenti i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, në të cilin janë përcaktuar objektivat dhe metodologjia e punës, si dhe është projektuar organizimi i procesit, duku u ndarë në 7 komponente apo shtylla në të cilat punohet paralelisht.

**AGJENDA EVROPIANE** – Ministria e Drejtësisë, gjatë periudhës raportuese, në funksion të zbatimit të Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) ka përfunduar procesin e hartimit të akteve ligjore dhe të njejtat janë aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke realizuar kështu, në afate rekorde, përgjegjësitë e marra në raport me zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA). Në kuadër të Agjendës për Integrim Evropian, Ministria e Drejtësisë, ka ndërmarrë të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me zbatimin e obligimeve të dala nga Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes Stabilizim Asociimit (PKZMSA-pjesa e MD), ERA dhe Dialogu i Nën Komitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri. Ministria e Drejtësisë,

gjatë kësaj periudhe ka monitoruar projektet në implementim në sektor të ndryshëm në kuadër të saj dhe ka filluar hartimin e termave të referencës për projekte të reja, në pajtim me objektivat e përcaktuara strategjike.

**BASHKËPUNIMI JURIDIK NDËRKOMBËTAR** - Janë finalizuar tri Marrëveshje Dypalëshe në çështje penale me Malin e Zi. Po ashtu, grupi punues për Marrëveshjen për Transferim të Personave të Dënuar me Italinë, kanë finalizuar tekstin e kësaj marrëveshjeje dhe të gjitha këto janë të gatshme për nënshkrim. Gjithashtu janë nënshkruar dy Marrëveshje Dypalëshe: 1) Traktati mes Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim dhe 2) Traktati mes Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Transferimin e Personave të Dënuar. Përveç kësaj, me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, janë iniciuar dhe propozuar 22 marrëveshje bilaterale: Marrëveshje për Ndhimë të Ndërsjellët Juridike në çështje penale, Transferimit të Personave të Dënuar dhe Ekstradim me 14 shtete të ndryshme. Gjithashtu janë finalizuar draftet e Marrëveshjeve për ndihmë juridike të ndërsjellë në çështjet civile me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Janë ekstraduar gjithsej 68 persona, dhe janë realizuar 4 transferime të personave të dënuar. Gjatë kësaj periudhës kohore janë proceduar 4583 kërkesa/përgjigje për ndihmë juridike ndërkombëtare. Me qëllim të forcimit të bashkëpunimit me organet kompetente, gjykatë, prokurori, polici në fushën e bashkëpunim juridik ndërkombëtarë janë organizuar tri punëtori tjetër, dy në fushën penale dhe një në civile. Gjithashtu janë përpiluar raporte periodike për zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe në fuqi.

**STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT PRONËSORE 2017-2021** - Ka vazhduar zbatimin e aktiviteteve për fuqizimin e profesioneve të lira përmes rishikimit dhe hartimit të projektligjeve të fushës civile. Ndryshimet në këto projektligje në fokus kanë qasjen më të lehtë në drejtësi për qytetarët e Kosovës për realizimin e të drejtave të tyre edhe jashtë procedurave gjyqësore, si dhe fuqizimin e rolit të gruas në trashëgimi. Në kuadër të zbatimit të kësaj Strategjie Kombëtare janë plotësuar dhe ndryshuar Ligji për Trashëgiminë, Ligji për Noterinë dhe Ligji për Procedurën Kontestimore.

Gjithashtu, është miratuar edhe Koncept-Dokumenti për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore ndërsa Ligji është në procedurë të hartimit, në proces të hartimit janë edhe Projektligji për Prone Publike, Projektligji për Token Ndërtimore, Koncept Dokumenti për transformim e qirasë 99 vjeçare në pronësi, si dhe Koncept Dokumenti për Procedurën kontestimore i cili ka kaluar të gjitha fazat e konsultimit dhe se shpejti do të dërgohet për shqyrtim dhe aprovim në Qeveri.

**SHËRBIMI KORREKTUES** - ka trajtuar gjithsej 2956 të burgosur. Me qëllim të zhvillimit të programeve për de-radikalizimin e të burgosurve Ministria e Drejtësisë/SHKK ka nënshkruar marrëveshje me Bashkësinë Islame të Kosovës. Me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës ka filluar së zbatuari moduli për programe rehabilituese për të burgosur ku është bërë pilotimi i seanceve rehabilituese për të burgosur në Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë; Është hartuar Strategjia për parandalimin e vetëvrasjeve në burgje në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë përkatësisht Departamentin e Shëndetësor të Burgjeve, si dhe është hartuar Udhëzuesi për mekanizmin e ankesave të burgosurve. Janë bërë parapërgatitjet për funksionalizimin e Qendrës së

vlerësimin për të burgosur, duke përfshirë trajnimin e tyre. Në aspektin preventiv, SHKK ka organizuar kontrolle për ta parandaluar kontrabandën, zbulimin e substancave narkotike nëpër institucione korrektuese. Janë siguruar pajisje teknike për rritjen e sigurisë për të gjitha burgjet. Në aspektin Infrastruktural, është bërë pranimi i objektit të ri të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë është në proces të funksionalizimit, është bërë renovimi i qendrës për aftësim profesional në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë, në Qendrën Korrektuese në Dubravë, dhe janë realizuar renovimet e nevojshme të hapësirave në institucionet korrektuese.

**INSPEKORIATI I MINISTRISË SË DREJTËSISË** - Gjatë kësaj periudhe kohore ka realizuar 37 inspektime në fushat e të drejtave të të burgosurve, në parandalimin e kontrabandës, në fushën e sigurisë, pranimin e të burgosurve, zbatimin e rutinave ditore dhe transferet e të burgosurve. Gjatë këtyre aktiviteteve Inspektorati ka lëshuar 61 rekomandime në fushat e inspektuara.

**SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS** - Gjatë kësaj periudhe aktivitetet më të rëndësishme kanë qenë: Mbikëqyrja e 1945 rasteve me masa dhe dënime alternative, të shqiptuara nga prokuroritë dhe gjykatat e Kosovës. Prej tyre, 1423 raste janë persona të mitur, kurse 522 raste janë persona madhor. Numri i përgjithshëm i rasteve të përfunduara gjatë këtij viti janë 1293 kurse në ekzekutim janë 652 raste. Janë realizuar 2156 anketa të plota sociale për të mitur dhe 10 raporte para ndëshkuese. Nga Paneli i Lirimit me Kusht janë trajtuar gjithsej 321 persona të liruar me kusht. Programi i përkujdesjes pas lirimit për të miturit ka pasur në mbikëqyrje 62 persona. Me qëllim të senzibilizimit të opinionit për rëndësinë e dënimeve alternative, janë realizuar 5 tryeza pune, në Zyrat Rajonale të SHSK-së, lidhur me efikasitetin e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative si dhe rritjen e bashkëpunimit me partneret e drejtësisë dhe institucione tjera. Janë hartuar Kurrikulat Bazike për SHSK-në, të cilat janë në procesin e validimit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit (AKK)/MASHT.

**AGJENCIA PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR-** Gjatë kësaj periudhe ka përmbytur këto aktivitete: Janë hartuar dy aktet nënligjore në zbatim të Ligjit për AAPSK-në. Në vitin 2017 Agjencia ka ekzekutuar gjithsej 138 vendime, nga të cilat 78 vendime janë për sekuestrimin e pasurisë, 39 vendime janë për konfiskimin e pasurisë, 18 vendime janë për kthimin e pasurisë së sekuestruar dhe 3 vendime të pasurive për dhënien në shfrytëzim për institucionet e Republikës së Kosovës. Vlera e përafërt e vlerësuar e pasurive të administruara nga Agjencia gjatë kësaj periudhe raportuese është rreth 1,619,855.41€, ku prej tyre përmbyledhja e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (mallra-kapitale) është rreth 1,256,080.31€, ndërsa shuma e mjeteve të realizuara nga të hyrat e konfiskuara dhe depozitat e sekuestruara është në shumë prej 363,775.10€ (para kesh, nga shitja dhe qiraja e PSK). AAPSK për periudhën Janar-qershor të 2018 ka ekzekutuar gjithsej 35 vendime nga të cilat 26 vendime janë për sekuestrimin e pasurisë, 9 vendime janë për konfiskimin e pasurisë, 11 vendime janë për kthimin e pasurisë së sekuestruar dhe 5 vendime të pasurive për dhënien në shfrytëzim për institucionet e Republikës së Kosovës. Vlera e përafërt e vlerësuar e pasurive të administruara nga Agjencia është rreth 522,202.27 €, ndërsa shuma e mjeteve të realizuara nga të hyrat e konfiskuara dhe depozitat e sekuestruara për periudhën Janar-Qershor 2018 është në shumë prej 236,199.68€ (para kesh, nga shitja dhe qiraja e PSK).

**INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE** -Në periudhën raportuese, ka kryer me sukses këto shërbime: janë realizuar 288 autopsi dhe 305 raporte të autopsisë, 62 ekzaminime dhe raporte 62 klinike mjeko ligjore; 97 rezultate të analizave histopatologjike dhe rezultate të analizave toksikologjike 327, ndërsa raporte të dorzuara nga Laboratori i Toksikologjisë janë gjithësej 82 raporte; Mjekësia Ligjore ka marrë pjesë në 19 operacione fushore në Kosovë dhe 1 në Serbi dhe 1 në Shqipëri, ku janë gjetur 52 mbetje mortore dhe janë në proces të Identifikimit. Nga rastet e luftës janë kryer 43 autopsi, 111 raste janë konfirmime identifikime dhe 8 raste janë identifikime të reja, 71 janë ribashkime dhe 5 nga rastet janë identifikuar me metoda tradicionale, ku janë përgatitur tabelat krahasuese me dokumentacion përkatës me të dhënat para vdekjes (PM) dhe pas vdekjes (AM) rezultatet e ADN-së; 58 janë raporte nga zhvarrimet. Familjaret e Personave të Zhdukur janë informuar për identifikimin e 8 rasteve të reja, janë dorëzuar 10 raste të reja, Ri-informime për 71 raste ndërsa Ribashkime për 60 raste. Janë përfunduar dy module të trajnimit onlive me “Universitetin Licester” për dy antropologet mjekoligjor i mbështetur nga Ambasada Britaneze.

**PROFESIONET E LIRA LIGJORE**- Janë realizuar inspektime të rregullta dhe procedura disiplinore për përmbaruesit privat dhe noterët. Janë iniciuar procedurat për themelimin e Divizionit për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së Profesioneve të Lira, me qëllim të trajtimit më të mirë të përgjegjësisë dhe llogaridhënjës si dhe ushtrimin e mbikëqyrjes (inspektimin) e ligjshmërisë së punës së përmbaruesve privat, noterëve dhe ndërmjetësuesve në pajtim me legjislacionin në fuqi. Është organizuar, provimi i jurisprudencës tre herë brenda kësaj periudhe kohore, dhe me sukses e kanë kaluar provimin **281** kandidat. Në fushën e ndërmjetësimit, si e arritur konsiderohet licencimi i 19 ndërmjetësuesve të nacionalitetit serb në regjionin e Mitrovicës.

**AVOKATURA SHTETERORE**- gjatë kësaj periudhe ka hapur/pranuar **640** raste të Procedurës Kontestimore, Jokontestimore, Përmbarimore dhe Administrative. Ka pranuar gjithsej 2734 lëndë të reja. Ka përfaqësuar autoritete publike të Republikës së Kosovës në gjithsej **3553** seanca gjyqësore, raste të procedurave të ndryshme. Ka ushtruar: Përgjigje në padi 684, Padi 98, Parashtresa 272, Ankesa 223 , Prapësime 24, Përgjigje në prapsim 10 , Revizion 9, Përgjigje në ankesë 10, Fjalë përfundimtare 6, Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë 4, Kthim në gjendje të mëparshme 5.

**INSTITUTI I HULUMTIMEVE TË KRIMEVE TË LUFTES** - ka vazhduar me hulumtimet e lokacioneve të ndryshme të masakrave të kryera gjatë luftës në Kosovë, si dhe me një numër publikimeve.